



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
KOMISIONI I MBROJTJES NGA RREZATIMET

Nr 177/prot
28

Tiranë, më 04.08/2022

Lënda: Procedurat, vlerësimi i aplikimit për pajisje me akt miratimi të veprimtarive me burime të rrezatimit jojonizues, formati i aplikimit dhe formati shpjegues për aplikimet online.

PROCEDURAT, VLERËSIMI I APLIKIMIT PËR PAJISJE ME AKT MIRATIMI TË VEPRIMTARIVE ME BURIME TË RREZATIMIT JOJONIZUES, DHE FORMATI SHPJEGUES PËR APLIKIMET ONLINE.

Aplikimi për pajisjen me akt miratimi bëhet për të gjitha veprimtaritë që i parashikon ligji “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese” Nr.10469, datë 13.10.2011. Aplikimi për akt miratimi bëhet online nëpërmjet sistemit e-albania. Plotësimi i aplikimit bëhet online. Personi përgjegjës i ZMR-së pas njoftimit online bën një vlerësim të përgjithshëm të aplikimit duke parë plotësimin e të gjitha rubrikave dhe njoftohet Kryetari për procedurë të mëtejshme, jo më vonë se 24 orë nga momenti i aplikimit. Në qoftë se për arsye të ndryshme personi përgjegjës nuk gjendet në ZMR, paraprakisht kjo detyrë i ngarkohet në mënyrë të përkohshme një prej inspektorëve të ZMR-së me miratim të Kryetarit.

Për plotësimin e raportit vlerësues mund të kërkohen dokumente shtesë, kur është e nevojshme, ose bëhet verifikimi në vend nëpërmjet një inspektimi në ambjentet, ku do të kryhet veprimtaria. Ky vlerësim bazohet në metodikën e llogaritjes së përmasave të zonës kritike të shpërhapjes së rrezatimit të një antene celulare miratuar nga ana e KMR-së (Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet) Nr. 822/2 datë 13/02/2013.

Raporti vlerësues duhet të jetë i plotë dhe duhet të përfshijë të gjithë elementet sipas Modelit për Vlerësim (bashkëngjitur këtij materiali). Të sigurojë që e gjithë veprimtaria, është në përputhje me rregulloren dhe metodikën e miratuar, si dhe të gjithë elementet e aplikimit për aktin e miratimit të jenë plotësuar. Ky raport vlerësues përgatitet brenda 1 dite. Raporti mban në fund firmën e vlerësuesit dhe datën e dorëzimit tek Kryetari i ZMR-së.

Ky raport i paraqitet Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet për dhënien e vendimit përfundimtar në lidhje me praktikën. Mbas miratimit nga KMR firmoset dosja përfundimtare nga Kryetari i ZMR.

Veprimtaria për miratimin nga ana e KMR do mbetet jashtë sistemit e-albania.

E gjithë veprimtaria e ZMR do të jetë në përputhje me sistemin e-albania. Në rastet kur nuk ka sistem aplikimi për akt-miratimi bëhet pranë ZMR tek personi i ngarkuar për këtë qëllim.

E gjithë veprimtaria e mësipërme në ZMR duhet të jetë pjesë e punës në grup, si element shumë i rëndësishëm në realizimin me sukses të detyrave.

Bashkëngjitur këtij dokumenti janë;

-formati i aplikimit për pajisje me akt miratimi me burime të rrezatimit jojonizues dhe formati shpjegues

-formati i aplikimit për amendim të akt miratimit me burime të rrezatimit jojonizues dhe formati shpjegues.

Vlerësim i aplikimit për pajisjen me Akt Miratimi të veprimtarisë me burime të rrezatimit jojonizues

Subjekti (emri), me përfaqësues Z. ka aplikuar online në datë për t'u pajisur me akt miratimi / ose amendim të aktit të miratimit për veprimtari me burime të rrezatimit jojonizues. Stacioni bazë ndodhet në adresën: Rruga, Nr., Qyteti, Tel....., E-mail

Stacioni Bazë

Stacioni bazë ka të dhënat më poshtë:

Numër identifikues i SB. - Emërtim

Struktura e site-t: Mast/Kullë

Banda me frekuenca: MHz

Fuqitë e transmetuara në çdo cel dhe për çdo bandë:

Këndet (azimut-et) e celeve janë përkatësisht:

Subjekti në aplikimin e tij ka plotësuar rubrikat e aplikimit për akt miratimi, në përputhje me rregulloren Nr.743, datë 16.10.2012, "Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese".

Aplikimi

1-Subjekti ka plotësuar:

Aplikimin për akt miratimi.

Është paraqitur ekstrakti i QKR-së si dhe certifikata e konformitetit për stacionin bazë.

Është plotësuar aplikimi për akt miratimi me të gjitha të dhënat që kërkohen.Është paraqitur ekstrakti me të dhëna të qarta për subjektin dhe veprimtarinë në momentin e aplikimit.

2-Është paraqitur një kopje e certifikatës së konformitetit të pajisjeve gjeneruese të rrezatimit.

3-Studimi për vlerësimin e shpërndarjes së rrezatimit jojonizues është bërë nga një ekspert i njohur nga KMR Sipas procedurës së vlerësimit të aplikimit për njohje nga KMR si ekspert i kualifikuar për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese Nr. 3618/3 datë 13/05/2014. Në lidhje me këtë pikë, është paraqitur me shkrim nga ana e ekspertëve mbi shpërhapjen e rrezatimit jojonizues, në përputhje me dokumentin e miratuar nga KMR, Nr. 822/2 datë 13/02/2013, mbi metodikën e llogaritjes së përmasave të zonës kritike të shpërhapjes së rrezatimit të (një celi) celeve për çdo stacion bazë, si dhe dokumente të tjerë të miratuar nga ana e KMR-së. Ky raport është firmosur në çdo faqe si nga eksperti, ashtu dhe nga personi fizik/juridik .

Për Stacionet bazë të përbashkëta , është deklaruar në faqen e parë të raportit të vlerësimit të shpërndarjes së fushës së rrezatimit elektromagnetik rreth stacionit për secilin person fizik/juridik nëse ka apo jo ndryshime të fushës elektromagnetike rreth stacionit.

SBkompani ... ka ndryshim/ ska ndryshim

SBkompania

Në çdo faqe të raportit është vendosur vula lidhëse e personit fizik /juridik.

Në ekspertizë është paraqitur gjeometrikisht pozicioni i celit (celeve) të një stacioni bazë, të një operatori tjetër në mastin/kullën të ngritur në çati-tarracë/tokë të burimeve të tjera të rrezatimeve jojonizuese, kur celet janë në distancë më të vogël se 50m me celet e stacionit bazë në raport.

Raporti vlerësues ka një renditje metodike të paraqitjes të kërkesave rregullatore në raport. Raporti reflekton kërkesat e mbrojtjes së publikut në përputhje me rregulloren Nr. 743 dt. 16.10.2012, si më poshtë.

Është paraqitur ambienti/et ku kryhet veprimtaria me burime rrezatimi jojonizues.

Janë paraqitur të dhëna të sakta mbi topografinë e instalimit të stacionit bazë për të cilin kërkohet akt miratim.

Është dhënë një përshkrim i saktë i pozicionit të stacionit bazë koordinatat gjeografike të paraqitura në formën xx° (grade) $xx.x$ '(minuta) $xxx.xx$ " (sekonda), ndërtesave dhe objekteve rreth stacionit, duke përfshirë distancat, katet dhe lartësitë e objekteve. Ky përshkrim është dhënë në një planimetri, format A3 dhe në një shkallë 1:200. Kjo planimetri ka paraqitur pozicionet e instalimit të masteve dhe celeve dhe azimutet e emërtuara.

Janë paraqitur foto prezantuese të antenës, stacionit bazë dhe pozicionit të kullës (në tokë) dhe mastit (në tarracë-çati etj) si dhe objekteve dhe ndërtesave rreth stacionit..

Përpara aplikimit për akt miratimi, operatorët të sigurojnë nëse ka hapësirë të mëtijshme për të shtuar frekuenca të reja në atë zonë, brenda limiteve rregullatore

Eksperti ka paraqitur në raport;

- Tipet e antenave të instaluar.
- Lartësinë e pozicionimit të burimit të rrezatimit jojonizues
- Fuqitë në hyrje në çdo cel, për çdo bandë dhe bandat e frekuencave të operimit.
- Koeficientin e amplifikimit në lobin qendror të antenës dhe koeficientin e amplifikimit në lobin dytësor më të madh (të nxjerra nga të dhënat e pasaportës së antenës).
- Azimutin e çdo celi.
- Përkuljet mekanike dhe elektrike të çdo celi .
- Këndi i hapjes vertikale të tufës së çdo celi
- Lartësinë e pikës mbi të cilën janë bërë llogaritjet.
- Nëse ka cele të afërta që ndikojnë në vlerësim, duhet të përcaktojnë shtrirjen hapësinore të Zonës Kritike rezultante .

- Ka përcaktuar se fusha rezultante nuk e kalon kufirin e lejuar.
- Është bërë paraqitja grafike e zonës kritike në planet xOz për çdo cel dhe kur ka elemente ndërhyrës në drejtimet e tjera të jepen edhe sipas xOy dhe yOz , ose të jepen koordinatat e projeksioneve të pikave ekstreme të zonës kritike.

Eksperti në vlerësimin e tij ka marrë në shqyrtim parametrat me të cilët bëhet ekspozimi maksimal, për skenarin më të keq të mundur i cili rezulton në favor të mbrojtjes së publikut.

Për cele të afërta të kompanive të tjera në distancë më të vogël se 50m nga celet e stacionit në vlerësim eksperti ka marrë në konsideratë zonën kritike rezultante. Në rastin kur nuk është e mundur gjetja e të dhënave të stacioneve të tjera fqinje, eksperti përdor të dhëna në dobi të publikut, duke konsideruar për stacionet bazë fqinje fuqitë maksimale të lejuara për operim nga Autoriteti Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP).


Mosdeklarimi i të dhënave të sakta të stacionit dhe gjeneratorëve të burimeve të rrezatimit jojonizues, që implikojnë fushën e përhapjes së stacionit, mbeten përgjegjësi e personit fizik/juridik.

Në çdo vlerësim për akt miratimi eksperti duhet të provojë me shkrim, se përmasat e zonës kritike rezultante janë të tilla, që nuk prekin zonat publike dhe janë në përputhje me VKM, Nr.743, datë 16.10.2012, Rregullore “Për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese”

Inspektori i ZMR-së bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe në vlerësimin e ekspertit mendon që veprimtaria e këtij stacioni me burime të rrezatimit jojonizues është në përputhje me rregulloret në fuqi, si dhe rubrikat e aplikimit për akt miratimi /amendim të akt miratimit janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Inspektori

Tiranë më



SEKRETARI

Rustem PACI



Ogerta MANASTIRLIU